



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 659/5 Prot.

Tiranë, më 12.11.2020

V E N D I M

Nr.143, datë 12.11.2020

“Mbi përfundimin e hetimit administrativ për vlerësimin e ligjshmërisë të Vendimit nr.141, datë 22.04.2020, të Kryetarit të Bashkisë Memaliaj, për lirimin nga shërbimi civil të punonjësit **, si pasojë e ristrukturimit të institucionit Bashkia Memaliaj”***

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në neniet 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 79 – 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e informacionit të protokolluar pranë Komisionerit me nr. 659 prot., datë 05.08.2020, për disa pretendime për paligjshmëri, të ngritura nga nëpunësi ***** në lidhje me procedurën e lirim të tij nga detyra “Drejtor i Qendrës Kulturore të Fëmijeve” në Bashkinë Memaliaj, për shkak të ristrukturimit të institucionit Bashkia Memaliaj,

VËREJ SE:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 659 prot., datë 05.08.2020, nëpunësi ***** ka ngritur disa pretendime për parregullsi dhe shkelje të lejuara në zbatimin e ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, gjatë procesit administrativ të lirim të tij nga detyra Drejtor i Qendrës Kulturore të Fëmijeve” në Bashkinë Memaliaj, si pasojë e ristrukturimit të institucionit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur gjatë hetimit administrativ të çështjes, ka rezultuar e vërtetuar se duke filluar nga muaji Dhjetor 2015, punonjësi ***** ka qenë

i punësuar në pozicionin e punës “Instruktur në Qendrën Kulturore të Fëmijëve”, në Bashkinë Memaliaj. Më pas me urdhrin nr. 60, datë 28.02.2020, të Kryetarit të Bashkisë Memaliaj, është emëruar në pozicionin e punës “Specialist Shërbimesh”, në Ndërmarrjen e Shërbimeve Shkollore, Rrugëve Rurale, Gjellbërimit, Ndriçimit dhe Varrezave Publike, në Bashkinë Memaliaj, ku vazhdoi të punonte deri në momentin e implementimit të strukturës së miratuar për vitin 2019-2020.

Në zbatim të strukturës së re, Kryetari i Bashkisë Memaliaj me Vendimin nr. 141, datë 22.04.2020, “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës”, bazuar në nenin 64, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neneve 142-156, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, ka urdhëruar lirimin e tij nga detyra “Specialist Shërbimesh”, në Ndërmarrjen e Shërbimeve Shkollore, Rrugëve Rurale, Gjellbërimit, Ndriçimit dhe Varrezave Publike, në Bashkinë Memaliaj.

Nisur nga parashtrimi i fakteve si më sipër, pas analizës së natyrës së punësimit të nëpunësit *****, arrijmë në përfundimin se ai ka qenë punësuar në institucione dhe ndërmarje varësie të Bashkisë Memaliaj, pozicione këto që nuk përfshihen në shërbimin civil, për rrjedhojë mosmarrëveshja e lindur me rastin e lirimt të tij nga detyra, nuk përfshihet në juridiksionin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, përcaktuar në nenin 11/1, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Ndërkaq, gjatë shqyrtimit të kësaj çështje, është mësuar edhe fakti që, punonjësi në fjalë, për këtë mosmarrëveshje i është drejtuar Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, (vërtetuar kjo me aktin nr. 493, datë 08.06.2020, “Njoftim”, drejtuar Bashkisë Memaliaj), e cila ka filluar shqyrtimin e saj.

Nga gjithë sa u parashtrua më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, arrin në përfundimin se bazuar në nenin 11/1, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe në parimin e sanksionuar në nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, sipas të cilit institucionet e tjera nuk mund të trajtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, nuk mund të vijoje më tej hetimi administrativ, pasi mosmarrëveshja do të zgjidhet përfundimisht nga gjykata, duke rregulluar dhe pasojat e saj.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 16, pika “6”, të Rregullores “Për procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, filluar në bazë të kërkesës nr. 659 prot., datë 05.08.2020, të punonjësit *****, në lidhje me disa pretendime për parregullsi të kryera apo lejuara në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë procesit administrativ të lirimit të tij nga detyra në pozicionin “*Drejtor i Qendrës Kulturore të Fëmijeve*”, në Bashkinë Memaliaj, si pasojë e ristrukturimit të institucionit në Bashkinë Memaliaj dhe arkivimin e çështjes.
2. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Memaliaj, njësia e burimeve njerëzore të Bashkisë Memaliaj dhe kërkuesi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha